

VENDIM
Nr. 241, datë 18.3.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr. 1 (kreu 1.8), e përmendur në pikën 2, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 1 (kreu 1.8), që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;
 - b) Lidhja nr. 2 (kreu 2.7), e përmendur në pikën 3, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 2 (kreu 2.7), që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, të përballohen nga fondet e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë, miratuar për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA I (KREU 1.8)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË URGJENCAVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtör	14000	2%		91700		Nga.deri lekë
2	Kryepilot	14000	2%		73000	8000	Nga.deri lekë
3	Pilot	14000	2%		71000	8000	Nga.deri lekë
4	Teknik helikopteri	14000	2%		68000		Nga.deri lekë
5	Shef sektori	14000	2%		41300		Nga.deri lekë
6	Specialist i lartë	14000	2%		31050		Nga..deri lekë

LIDHJA 2 (kreu 2.7)

STRUKTURA E PAGAVE PËR TEKNIKËT NË QENDRËN KOMBËTARE TË
URGJENCAVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm Teknik elektrik		2%	0	32000		Nga...deri lekë